

IKAF F9 Menaxhimi Financiar

Syllabus dhe Udhëzues Studimi

*Kualifikimi Kontabilist i Certifikuar
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Ky planprogram dhe udhëzuesi i studimit është i dizajnuar për të ndihmuar në mësimdhënie dhe mësimnxënie, dhe ka për qëllim të ofrojë informata të hollësishme në lidhje me kualifikimin, modulën dhe udhëzuesin e studimit.

Struktura e Kualifikimit

Shpjegon përmbajtjen e kualifikimit të nivelit Kontabilist i Certifikuar në të cilën bënë pjesë edhe moduli Menaxhimi Financiar. Ndërlidhja e këtij moduli me nivelet dhe modulet tjera të kualifikimit. Modulet e përfshira në nivelin e caktuar si dhe kriteret për antarësim; si dhe karakteristikat e ligjeratave të cilat mbahen gjatë periudhës së certifikimit. Modulet dhe Kualifikimi janë paraqitur edhe me anë të diagramit.

Moduli

Shpjegon shkurtimisht arsyetimin e rëndësisë së modulit, objektivat e përgjithshme dhe të detajuara të modulit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që do të zhvillohen gjatë studimit të modulit në fjalë. Ndërlidhja e modulit me modulet tjera të caktuara paraqitet me anë të një diagrami, që paraqesin lidhjet ndërmjet tyre; me qëllim që të jetë sa më e qartë për lexuesin. Poashtu përshkruhen dhe temat që i përkasin modulit; se si është planifikuar moduli me tema dhe nëntema. Gjithashtu, shpjegohen edhe forma e ekzaminimit dhe vlerësimit, në detaje se çfarë do të shqyrtojë provimi dhe pse. Në fund krejt është bashkangjitur shtojca e përmbajtjes së modulit.

Struktura e Syllabusit

Shpjegon përmbajtjen e syllabusit të modulit Menaxhimi Financiar i cili është pjesë e nivelit Kontabilist i Certifikuar. Ky modul përmban arsyetimin, qëllimin dhe aftësitë kryesore që pritet të fitohen gjatë kohës së studimit. Veç kësaj syllabusi përfshinë edhe temat e modulit në fjalë, strukturën e ekzaminimit pas përfundimit me sukses të modulit si dhe të lexuarit dhe planifikimin e kohës.

Udhëzuesi i Studimit

Ky është seksioni kryesor i të dhënave që nxënësit dhe mësimdhënësit duhet ta përdorin si bazë të studimeve, mësimve dhe materialeve të tyre përkatësisht. Provimet do të bazohen në detajet e udhëzuesit të studimit i cili identifikon në mënyrë gjithëpërfshirëse se çfarë mund të vlerësohet në çdo seancë provuese. Udhëzuesi i studimit është i ndarë në seksione të bazuara në aftësitë kryesore të identifikuara në programin mësimor. Këto seksione ndahen në fusha të lëndëve që lidhen me nën-aftësitë e përfshira në planprogramin e detajuar. Fushat e lëndëve ndahen në nëntituj që përshkruajnë rezultatet e detajuara që mund të vlerësohen në provime.


STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

*Kualifikimi Kontabilist i Certifikuar
(Bazuar në Certifikimet ACCA)*

Planprogrami për kualifikim për Kontabilist të Çertifikuar siguron një theks të veçantë në aftësitë e raportimit financiar të cilat janë zhvilluar në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Kontabilistët e Çertifikuar do të mësojnë parimet dhe sistemet e kontrollit të brendshëm për ndërmarrjet, metodat e auditimit dhe standardet si dhe një grup të gjerë të planifikimit të biznesit, mbështetjen e vendimeve dhe aftësitë e menaxhimit të performancës.

Për t'u trajnuar për Kontabilist të Çertifikuar ju duhet së pari të përfundoni kualifikimin për Teknik të Kontabilitetit. Anëtarësia për Kontabilist të Çertifikuar është e hapur për profesionistët të cilët punojnë në kontabilitet e të cilët kanë përfunduar kualifikimin e IKAF për Teknik të Kontabilitetit.


Kandidatët në Kualifikimin për Kontabilist të Certifikuar duhet të demonstrojnë njohuri të veçanta edhe në modulin "Menaxhimi Financiar".



Diagrami.1.: Nderlidhjet e moduleve dhe certifikimeve deri tek titulli Kontabilist i Certifikuar

Modulet

Kualifikimi Kontabilist i Certifikuar përmbanë gjithsej pesë module të cilat duhet të studiohen dhe të përfundojnë me sukses; me qëllim të fitimit të titullit.



Diagrami.2.: Modulet e Kualifikimit Kontabilist i Certifikuar

Kriteret e kualifikimit dhe anetaresimit: Kontabilist të Certifikuar

- Diplomë Universitare;
- Përfundimin e nivelit për Teknik të Kontabilitetit;
- Dëshmi për së paku tre (3) vite përvojë pune të verifikuar në kontabilitet - që mund të përfitohet edhe gjatë apo pas trajnimit.
- Të kenë vijuar dhe kaluar pesë (5) provimet e certifikimit për këtë qëllim (Provimi quhet i dhene nese arrihet 50% e pikeve ne test).
- Personi që është i certifikuar në këtë kualifikim nga IKAF dhe vazhdon të jetë anëtar me status të rregullt pranë IKAF-it, ka të drejtë të përdor titullin “Kontabilist të Çertifikuar” duke plotësuar gjitha kriteret e mesiperme.
- Antaret e rregullt ne IKAF për ta përdor titullin “Kontabilist të Çertifikuar” e kane obligative ndjekjen e edukimit te vazhdueshem professional (EVP/CPD) te percaktuara edhe ne rregullore te IKAF-it.

Karakteristikat e ligjertes trajnuese:

- Rishikimi i përgjithshëm i moduleve dhe gjatë ligjertes, studentët do të jenë të pajisur me raste të studimit, shembujve të ngjashëm nga ato që trajtohen të testet ACCA, dhe shmebuj të provimeve.
- Ligjertesit mbajnë kualifikime profesionale si dhe eksperience pune në fushen e caktuar të ligjerimit.
- Planprogrami trjanues është i bazuar në planëprogramet ACCA.
- Në përfundim të kësaj ligjerate, studentet do të jenë te gatshëm ti nënshtrohen provimit në qendren e Institutit KAF.

STRUKTURA E SYLLABUSIT

Arsyetimi

Shpjegon se si është strukturuar programi dhe si janë të ndërlidhura aftësitë kryesore. Arsyetimi gjithashtu shpjegon në detaje se çfarë do të përmbajë ekzaminimi dhe pse.

Diagrami i relacioneve mes moduleve

Ky diagram tregon lidhjet e drejtpërdrejta dhe të tërthorta midis këtij moduli dhe moduleve të tjera që i paraprijnë ose pasojnë. Ai tregon se ku ju pritët të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni të mësuarit e mëparshëm përpara se të filloni studimin.

Qëllimi

Kjo shpjegon shkurtimisht objektivin e përgjithshëm të planprogramit dhe tregon në kuptimin më të gjerë aftësitë që duhet të zhvillohen brenda studimit të modulit.

Aftësitë kryesore

Qëllimi i planit mësimor është i ndarë në disa funksione kryesore që ndajnë programin mësimor dhe udhëzuesin studimor në seksione diskrete.

Temat

Temat e caktuara që i përmbanë moduli dhe që do të trajtohen gjatë studimit dhe ligjerimit.

Struktura e Ekzaminimit

Ky seksion shpjegon shkurtimisht strukturën e ekzaminimit dhe si bëhet vlerësimi.

Shtojcë Syllabusi i Detajuar

Kjo tregon ndarjen temave dhe nëntemave kryesore të planprogramit në fushat e lëndëve. Ky është pilotprojekt për manualin e detajuar të studimit.

MODULI

Ky syllabus dhe manual studimi është krijuar për të ndihmuar në planifikimin e studimeve dhe sigurimin e informacioneve më të detajuara mbi atë që mund të jetë pjesë e testimit vlerësues.

Arsyetimi

Syllabusi për Menaxhimin Financiar ka lidhje të drejtpërdrejta dhe të tërthorta me modulet e tjera që i paraprike ose më të avancuara. Disa module janë mbështetur drejtpërdrejt nga module të tjera të tilla si Menaxhimi i Avancuar Financiar nga Menaxhimi Financiar. Ndërsa modulet e tjera kanë vetëm marrëdhënie të tërthorta me njëra-tjetrën, siç janë lidhjet ekzistuese ndërmjet moduleve të kontabilitetit dhe auditimit. Ky diagram tregon se ku pritet të keni njohuri themelore dhe ku do të ishte e dobishme të rishikoni njohuritë e mëparshme.



Diagrami.1.: Ndërlidhja e moduleve

Syllabusi, fillon me prezentimin e rolit dhe qëllimin e funksionit të menaxhimit financiar brenda një biznesi. Pjesa tjetër e planprogramit ka të bëjë me vendimet e investimit. Kjo bëhet në dy faza: investimi në (dhe menaxhimi) i kapitalit qarkullues dhe vlerësimi i investimeve afatgjata. Fusha tjetër e inkuorporuar është vendimet e financimit. Ky seksion i planporgramit fillon duke shqyrtuar burimet e ndryshme të financimit të biznesit, duke përfshirë politikat e dividendëve dhe se sa financa mund të rriten nga brenda biznesit. Syllabusi përfundon me hyrjen dhe shqyrtimin e rrezikut dhe teknikat kryesore të përdorura në menaxhimin e një rreziku të tillë.

Qëllimi

Zhvillimi i njohurive dhe aftësive të pritura nga një menaxher finacniar, nëlidhje me investimet, financat dhe vendimet për politiken e dividendit.

Aftësitë kryesore

- Sqarimi i rolit dhe qëllimit të funksionit të menaxhimit financiar
- Vlerësimi dhe diskutimi i ndikimit të mjedisit ekonomik ndaj menaxhimit financiar
- Diskutimi dhe aplikimi i teknikave të menaxhimit të kapitalit punues

- Vlerësimi efikas i investimeve
- Identifikimi dhe vlerësimet e burimeve alternative të financave të biznesit
- Sqarimi dhe kalukimi i kostos së kapitalit dhe faktorët që kanë ndikim mbi atë
- Diskutimi dhe aplikimi i parimeve të biznesit dhe vlerësimi i pasurive
- Sqarimi dhe aplikimi i teknikave të menaxhimit të riskut

Temat

Temat kryesore të Modullit Menaxhimi Financiar që do të trajtohen gjatë ligjërates:



Diagrami.2.: Temat që do të trajtohen në Modulin Menaxhimi Financiar

Struktura e Ekzaminimit

Provimi mbahet në formë të shkruar dhe përmban pyetje nga të gjitha pjesët e tekstit. Testi do të ketë pyetje të hapura të cilat gjenden në kuadër të këtij teksti. Përgjigjet mund të nxirren nga leximi i tekstit dhe nga ligjëratat e mbajtura. Disa prej pyetjeve mund të kërkojnë përgjigje teorike, kurse pjesa më e madhe e tyre do të jenë pyetje të kombinuara dhe përgjigja jepet në kuadër të alternativave të dhëna në test.

Të lexuarit dhe planifikimi i kohës

Për 3 orët e provimit, janë konsideruar 15 minuta kohë për lexim dhe planifikim.

Kjo kohë shtesë është e lejuar në fillim të cdo provimi tre orësh për të lejuar kandidatët t'i lexojnë pyetjet dhe përgjigjet për të filluar planifikimin e tyre para se të fillojnë të shkruajnë përgjigjet. Kjo kohë duhet të përdoret për të siguruar që të gjitha informatat e kërkuara dhe provimi janë lexuar dhe kuptuar si duhet.

Shtojcë: Syllabusi i Detajuar

SYLLABUSI I DETAJUAR

A Funkzioni i menaxhimit financiar

1. Natyra dhe qëllimi i menaxhimit financiar
2. Objektivat financiare dhe marrëdhënia me strategjinë korporative
3. Grupet e interesit dhe ndikimi mbi objektivat korporative
4. Objektivat financiare dhe objektivat tjera në organizatat jo-fitimprurëse

B Mjedisi i menaxhimit financiar

1. Mjedisi ekonomik i biznesit
2. Natyra dhe roli i tregjeve dhe institucioneve financiare
3. Funkzioni i thesarit

C Menaxhimi i kapitalit punues

1. Natyra, elementet dhe rëndësia e kapitalit punues
2. Menaxhimi i inventarëve, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme dhe parave
3. Përcaktimi i nevojave për kapital punues dhe strategjitë e financimit

D Vlerësimi i investimeve

1. Teknikat e procesit të vlerësimit të investimeve
2. Vlerësimi i investimeve duke i marr parasysh inflacionin dhe tatimet
3. Rregullimi për rrezikun dhe pasigurinë në vlerësimin e investimit
4. Vendimet për investime specifike (lizing ose blerje; zëvendësim të pasurisë; racionimi i kapitalit)

E Financat e biznesit

1. Burimet e financave afatshkurta dhe mbledhja e tyre
2. Burimet e financave afatgjata dhe mbledhja e tyre
3. Mbledhja e financave afatshkurta dhe afatgjata nëpërmjet financimit islamik
4. Burimet e brendshme të financimit dhe politika e dividendëve
5. Leva dhe struktura e kapitalit
6. Financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (NVM)

F Kostoja e kapitalit

1. Burimet e financave dhe kostot e tyre
2. Vlerësimi i kostos së ekuitetit
3. Vlerësimi i kostos së borxhit dhe instrumenteve tjera kapitale
4. Vlerësimi i kostos së përgjithshme të kapitalit
5. Teoritë e strukturës së kapitalit dhe konsideratat praktike
6. Ndikimi i kostos së kapitalit mbi investimet

G Vlerësimet e biznesit

1. Natyra dhe qëllimi i vlerësimit të biznesit dhe pasurive financiare
2. Modelet për vlerësimin e aksioneve
3. Vlerësimi i borxhit dhe pasurive tjera financiare
4. Hipoteza për tregun efikas (EMH) dhe konsideratat praktike në vlerësimin e aksioneve

H Menaxhimi i rrezikut

1. Natyra dhe llojet e rrezikut dhe qasjet në menaxhimin e rrezikut

2. Arsyet për dallimet e kursit të këmbimit dhe luhatjet e normës së interesit
5. nga rreziku i normës së interesit
3. Teknikat mbrojtëse nga rreziku i monedhës së huaj
4. Teknikat mbrojtëse

Udhëzuesi i Studimit

A Funkioni i menaxhimit financiar

1. Natyra dhe qëllimi i menaxhimit financiar

- a) Të kuptuarit e natyrës dhe qëllimit të menaxhimit financiar.
- b) Të kuptuarit e marrëdhënies në mes menaxhimit financiar dhe kontabilitetit financiar dhe menaxherial.

2. Objektivat financiare dhe marrëdhënia me strategjinë korporative

- b. Marrëdhënia në mes objektivave financiare, objektivave korporative dhe strategjisë korporative.
- c. Identifikimi dhe përshkrimi i objektivave financiare të ndryshme duke përfshirë:
 - ii. maksimizimin e pasurive të aksionarëve
 - iii. maksimizimin e fitimit
 - iv. rritjen e fitimit për aksion.

3. Grupet e interesit dhe ndikimi mbi objektivat korporative

- a) Identifikimi i gamës së grupeve të interesit dhe objektivat e tyre.
- b) Konfliktet e mundshme në mes objektivave të grupeve të interesit.
- c) Roli i menaxhimit në përmbushjen e objektivave të grupeve të interesit, duke përfshirë zbatimin e teorisë së agjentëve.
- d) Përshkrimi dhe aplikimi i mënyrave të matjes së objektivave korporative duke përfshirë:
 - i. Analizën e raporteve, duke përdorur raportet e përshtatshme si kthimi I kapitalit

i përdorur, kthimi i ekuitetit, fitimet për aksion dhe dividendë për aksion.

- ii. Ndryshimet në dividendët dhe çmimet e aksioneve si pjesë të kthimit gjithsej të aksionarëve.
- iii. Të kuptuarit e mënyrave për të inkurajuar arritjen e objektivave të grupeve të interesit, duke përfshirë:
 - i. Skemat për shpërblim të menaxherëve si opsionet e aksioneve dhe pagesa lidhur me performancën
 - ii. Kërkesat rregullative si kodet e qeverisjes korporative të praktikave më të mira dhe rregullimet e tregtisë së aksioneve në bursë.

4. Objektivat financiare dhe objektivat tjera në organizatat jo-fitimprurëse

- a) Ndikimi i statusit jo-fitimprodhues mbi objektivat financiare dhe objektivat tjera.
- b) Natyra dhe rëndësia e vlera për para si një objektivi në organizatat jo-fitimprodhuese.
- c) Mënyrat e matjes së arritjes së objektivave në organizatat jo-fitimprodhuese.

B Mjedisi i menaxhimit financiar

1. Mjedisi ekonomik i biznesit

- a) Identifikimi dhe sqarimi i qëllimeve kryesore të politikave makroekonomike.
- b) Definimi dhe sqarimi i politikave fiskale, politikave monetare, politikave të normave të interesit dhe politikave të kurseve të këmbimit në arritjen e qëllimeve kryesore të politikave makroekonomike.
- c) Të kuptuarit e bashkëveprimit të politikës ekonomike qeveritare me planifikimin dhe
 - i. sjelljen e vendimeve të biznesit.

- d) Nevoja dhe bashkëveprimi me planifikimin dhe sjelljen e vendimeve në biznes për:
 - ii. politikën e konkurrencës
 - iii. ndihmën qeveritare për bizneset
 - iii. politikat e mjedisit
 - iv. rregullimin e qeverisjes korporative

2. Natyra dhe roli i tregjeve dhe institucioneve financiare

- a) Identifikimi i natyrës dhe rolit të tregjeve të parave dhe tregjeve të kapitalit, kombëtare dhe ndërkombëtare.
- b) Të kuptuarit e rolit të ndërmjetësve financiarë.
- c) Të kuptuarit e funksioneve të tregut të aksioneve dhe tregut të obligacioneve korporative.
- d) Të kuptuarit e natyrës dhe karakteristikave të letrave me vlerë të ndryshme në lidhje me rrezikun/kthimin

3. Funksioni i thesarit

- a) Përshkrimi i rolit të tregjeve të parave në:
 - Sigurimin e likuiditetit afatshkurtër të industrisë dhe të sektorit publik
 - Sigurimin e financave afatshkurta për tregti
 - Lejimin e organizatës të menaxhoj ekspozimin e saj ndaj FOREX-it dhe rrezikut të normës së interesit.
- b) Të kuptuarit e rolit të bankave dhe institucioneve tjera financiare në funksionimin e tregjeve të parasë.
- c) Të kuptuarit e karakteristikave dhe rolit të instrumenteve kryesore të tregut të parasë:
 - Instrumentet që bartin interes
 - Instrumentet e skontimit

- Produktet derivative

C Menaxhimi i kapitalit punues

1. Natyra, elementet dhe rëndësia e kapitalit punues

- a) Natyra dhe elementet e kapitalit punues.
- b) Identifikimi i objektivave të menaxhimit të kapitalit punues në terme të likuiditetit dhe rentabilitetit dhe konflikti në mes tyre.
- c) Roli kryesor i menaxhimit të kapitalit punues në menaxhimin financiar.

2. Menaxhimi i inventarëve, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme dhe parave

- a) Të kuptuarit e ciklit operativ të parave dhe roli i llogarive të pagueshme dhe llogarive të arkëtueshme.
- b) Kuptimi dhe përdorimi i raporteve relevante të kontabilitetit duke përfshirë:
 - raportin aktual dhe raportin e shpejtë
 - raportin e qarkullimit të inventarit, periudhën mesatare të mbledhjes, periudhën mesatare të pagesës të hyrat nga shitja/raportin e kapitalit punues neto
- c) Sqarimi, aplikimi dhe vlerësimi i përdorimit të teknikave relevante në menaxhim të inventarit, duke përfshirë modelin ekonomik të sasisë së porositur dhe teknikat pikërisht në kohë.
- d) Sqarimi, aplikimi dhe vlerësimi i përdorimit të teknikave relevante në menaxhimin e llogarive të arkëtueshme, duke përfshirë:
 - i. vlerësimin e aftësisë huamarrëse
 - ii. menaxhimin e llogarive të arkëtueshme
 - iii. mbledhjen e shumave të papranuara
 - iv. ofrimin e skontimeve për pagesat e mëhershme

- v. përdorimin e faktoringut dhe skontimin e faturave
 - vi. menaxhimin e llogarive të arkëtueshme të blerësve të huaj
- e) Sqarimi dhe aplikimi i përdorimit të teknikave relevante në menaxhimin e llogarive të pagueshme, duke përfshirë:
- i. përdorimin efektiv të kredisë tregtare
 - ii. vlerësimin e përfitimeve nga skontimi për shlyerjen e mëhershme dhe për blerjen me sasi të mëdha
 - iii. menaxhimin e llogarive të pagueshme të furnitorëve të huaj

f) Sqarimi i arsyeve të ndryshme për mbajtjen e parave dhe sqarimi dhe aplikimi i përdorimit të teknikave relevante në menaxhimin e parave, duke përfshirë:

- i. përgatitjen e parashikimit të rrjedhjes së parasë që të përcaktohen rrjedhja e parasë dhe bilanci i parave
- ii. vlerësimin e përfitimeve nga menaxhimi i thesarit të centralizuar dhe kontrolli i parave
- iii. modelet e menaxhimit të parave, si modeli Baumol dhe modeli Miller-Orr
- iv. investimin afatshkurtër

3. Përcaktimi i nevojave për capital punues dhe strategjitë e financimit

- a) Kalkulimi i nivelit të investimeve të kapitalit punues në pasuri qarkulluese dhe sqarimi i faktorëve kryesor që përcaktojnë këtë nivel, duke përfshirë:
- i. kohëzgjatjen e ciklit të kapitalit punues dhe kushtet e tregtisë
 - ii. politikën e organizatës për nivelin e investimeve në pasuri qarkulluese
 - iii. industrinë në të cilën organizata operon
- b) Të kuptuarit e faktorëve kryesor në përcaktimin e strategjive të financimit të kapitalit punues, duke përfshirë:

- i. dallimin në mes pasurive të përhershme dhe të luhatshme
- ii. koston relative dhe rrezikun e financimit afatshkurtër dhe afatgjatë
- iii. parimin e përputhjes
- iv. kostot relative dhe përfitimet nga politikat agresive, konservatore dhe përputhëse të financimit
- v. qëndrimet e menaxhimit ndaj rrezikut, vendimeve të mëhershme të financimit dhe madhësisë së biznesit

D Vlerësimi i investimeve

1. Teknikat e procesit të vlerësimit të investimeve

- a) Identifikimi dhe kalkulimi i rrjedhjeve relevante të parasë për projektet investuese.
- b) Kalkulimi i periudhës së rimbursimit dhe dobia e saj si një metodë të vlerësimit të investimeve.
- c) Kalkulimi i kthimit të kapitalit të përdorur (kalkulimi i normës së kthimit) dhe dobia e tij si një metodë të vlerësimit të investimeve.
- d) Kalkulimi i vlerës aktuale neto dhe dobia e saj si një metodë të vlerësimit të investimeve.
- e) Kalkulimi i normës së brendshme të kthimit dhe dobia e saj si një metodë të vlerësimit të investimeve.
- f) Të kuptuarit e superioritetit të metodave DCF mbi metodat jo-DCF.

g) Të kuptuarit e meritave relative të NPV dhe IRR.

h) Kalkulimi i rimbursimit të skontuar dhe dobia e tij si një metodë të vlerësimit të investimeve

2. Vlerësimi i investimeve duke i marr parasysh inflacionin dhe tatimet

a) Aplikimi dhe sqarimi i termeve “reale” dhe “nominale” për vlerësimin e investimeve.

c) Kalkulimi i efekteve të tatimit mbi rrjedhjet relevante të parasë, duke përfshirë përfitimet tatimore të zbritjeve kapitale dhe detyrimet tatimore të fitimit të tatueshëm.

d) Kalkulimi dhe aplikimi i normave të skontimit para dhe pas tatimit.

3. Rregullimi për rrezikun dhe pasigurinë në vlerësimin e investimit

a) Të kuptuarit e dallimit në mes rrezikut dhe pasigurisë në lidhje me probabilitetin dhe rritjen e jetës së projektit.

b) Aplikimi i analizës së ndjeshmërisë ndaj projekteve investuese dhe dobia e saj në vlerësimin e vendimeve për investim.

c) Aplikimi i analizës së probabilitetit ndaj projekteve investuese dhe dobia e saj në vlerësimin e vendimeve për investim. iv.

d) Të kuptuarit e teknikave tjera të rregullimit të rrezikut dhe pasiguria në vlerësimin e investimeve duke përfshirë:

- i. simulimin
- ii. rregullimin e rimbursimit
- iii. normat e skontimit të rregulluara për rrezikun

4. Vendimet për investime specifike (lizing ose blerje; zëvendësim të pasurisë ose racionim të kapitalit)

a) Vlerësimi i lizingut dhe huamarrjes për blerjen duke përdorur kostot e huas para dhe pas tatimit

b) Vlerësimi i vendimeve për zëvendësim të pasurisë duke përdorur koston ekuivalente vjetore.

c) Vlerësimi i vendimeve për investim nën periudhën e vetme të racionimit të kapitalit, duke përfshirë:

i. kalkulimin e indekseve të rentabilitetit për projektet investuese të ndashme

ii. kalkulimin e vlerës aktuale neto të kombinimeve të projekteve investuese jo të ndashme

iii. sqarimin e arsyeve për racionimin e kapitalit

E Financat e biznesit

1. Burimet e financave afatshkurta dhe mbledhja e tyre

a) Identifikimi dhe sqarimi i gamës së burimeve të financave afatshkurta duke përfshirë:

- i. mbitërheqjen
- ii. huan afatshkurtër
- iii. kredinë tregtare

iv. financimin me lizing

2. Burimet e financave afatshkurta dhe mbledhja e tyre

a) Identifikimi dhe sqarimi i gamës së burimeve të financave afatgjata duke përfshirë:

- i. financat e ekuitetit
- ii. financat e borxhit

iii. financat e lizingut iv. kapitalin e përbashkët

- b) Identifikimi dhe sqarimi i metodave të mbledhjes së financave të ekuitetit, duke përfshirë:
- i. emetimin e të drejtave
 - ii. vendosjen
 - iii. ofertën publike
 - iv. listimin në bursë

3. Mbledhja e financave afatshkurta dhe afatgjata nëpërmjet financimit islamik

- a) Të kuptuarit e dallimeve në mes financave islamike dhe financave tjera konvencionale.
- b) Të kuptuarit e konceptit të interesit (riba) dhe kthimeve të letrave islamike me vlerë. (kalkulimet nuk janë të nevojshme).
- c) Identifikimi dhe sqarimi i gamës së instrumenteve financiare islamike (afatshkurta dhe afatgjata) që janë në dispozicion për bizneset duke përfshirë:
- i. kredinë tregtare (*murabaha*)
 - ii. financat e lizingut (*ijara*)
 - iii. financat e ekuitetit (*mudaraba*)
 - iv. financat e borxhit (*sukuk*)
 - v. kapitalin e përbashkët (*musharaka*)

4. Burimet e brendshme të financimit dhe politika e dividendëve

- a) Identifikimi dhe sqarimi i burimeve të brendshme të financimit duke i përfshirë:
- i. fitimet e mbajtura
 - ii. rritja e efikasitetit të menaxhimit të kapitalit punues.
- b) Të kuptuarit e marrëdhënieve në mes politikës së dividendëve dhe vendimeve për financim.

- c) Qasjet teorike dhe ndikimet praktike mbi vendimin për dividendë duke i përfshirë:
- i. kufizimet ligjore
 - ii. likuiditetin
 - iii. pritjet e aksionarëve
 - iv. alternativat tjera përveç pagesa e dividendëve me para

5. Leva dhe struktura e kapitalit

- a) Identifikimi dhe sqarimi i problemit të niveleve të mëdha të levës.
- b) Vlerësimi i ndikimit të burimeve të financave mbi pozicionin financiar dhe rrezikun financiar duke i përdorur masat e përshtatshme duke përfshirë:
- i. analizën e raporteve duke përdorur levën e bilancit të gjendjes, levën operative dhe financiare, raportin e mbulesës së interesit dhe raportet tjera relevante
 - ii. parashikimin e rrjedhjes së parasë
 - iii. efektin mbi pasurinë e aksionarëve

6. Financimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme

- a) Të kuptuarit e nevojave financiare të bizneseve të vogla.
- b) Të kuptuarit e natyrës së problemit të financimit për bizneset e vogla në terme të hapësirës së financimit, hapësirës së maturimit dhe sigurimit të pamjaftueshëm.
- c) Të kuptuarit e masave që mund të merren nga departamentin e qeverisë dhe institucionet financiare për lehtësimin e problemeve financiare të NVM.
- d) Identifikimi i burimeve të përshtatshme të financimit të NVM dhe vlerësimi i ndikimit financiar të burimeve të ndryshme të financave të NVM

F Burimet e financave

1. Burimet e financave dhe kostot e tyre

- a) Të kuptuarit e marrëdhënies rrezik-kthim dhe kostot relative të ekuitetit dhe borxhit.
- b) Të kuptuarit e hierarkisë së kreditorit dhe lidhja e saj me kostot relative të burimeve të financave.

2. Vlerësimi i kostos së ekuitetit

- a) Të kuptuarit e modelit të rritjes së dividendit dhe dobësitë e tij.
- b) Të kuptuarit e rrezikut sistematik dhe josistematik, dhe marrëdhëniet në mes teorisë së portofolit dhe modelit të vendosjes së çmimit të pasurive kapitale (CAPM).
- c) Aplikimi i modelit të vendosjes së çmimit të pasurive kapitale (CAPM) dhe supozimet dhe komponentët e këtij modelit.
- d) Avantazhet dhe disavantazhet e modelit të vendosjes së çmimit të pasurive kapitale (CAPM).

3. Vlerësimi i kostos së borxhit dhe instrumenteve tjera të kapitalit

- a) Kalkulimi i kostos së kapitalit të një game të instrumenteve të kapitalit duke përfshirë:
 - i. borxhin e patërheqshëm
 - ii. borxhin e tërheqshëm
 - iii. borxhin e konvertueshëm
 - iv. aksionet preferenciale
 - v. borxhin bankar

4. Vlerësimi i kostos së përgjithshme të kapitalit

- a) Dallimi në mes kostos mesatare të kapitalit dhe kostos marginale të kapitalit.
- b) Kalkulimi i kostos mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC) duke përdorur vlerën kontabël dhe vlerën e tregut.

5. Teoritë e strukturës së kapitalit dhe konsideratat praktike

- a) Pikëpamja tradicionale e strukturës së kapitalit dhe supozimet e saj.
- b) Përshkrimi i pikëpamjes së Miller dhe Modigliani për strukturën e kapitalit, pa dhe me tatim korporativ, dhe supozimi i saj.
- c) Identifikimi i gamës së papërsosmërive të tregut të kapitalit dhe përshkrimi i ndikimit të tyre mbi pikëpamjen e Miller dhe Modigliani për strukturën e kapitalit.
- d) Të kuptuarit e rëndësisë së teorisë së renditjes mbi zgjedhjen e burimeve të financave.

6. Ndikimi i kostos së kapitalit mbi investimet

- a) Të kuptuarit e marrëdhënies në mes vlerës së kompanisë dhe kostos së kapitalit.
- b) Rrethanat në të cilat kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit mund të përdoret në vlerësimin e investimit.
- c) Avantazhet e modelit të vendosjes së çmimit të pasurive kapitale (CAPM) mbi koston mesatare të ponderuar të kapitalit në përcaktimin e kostos së veçantë të kapitalit të një projekti.
- e) Aplikimi i modelit të çmimit të pasurive kapitale (CAPM) në kalkulimin e normës së veçantë skontimi të një projekti.

G Vlerësimet e biznesit

1. Natyra dhe qëllimi i vlerësimit të biznesit dhe pasurive financiare

- a) Identifikimi dhe kuptimi i arsyeve për vlerësimin e bizneseve dhe pasurive financiare.
- b) Identifikimi i kërkesave për informata për vlerësim dhe kufizimet e llojeve të ndryshme të informatave.

2. Modelet për vlerësimin e aksioneve

- a) Modelet e vlerësimit që bazohen në pasuritë:
 - i. Baza e vlerës kontabël neto
 - ii. Baza e vlerës së realizueshme neto
 - iii. Baza e kostos së zëvendësimit neto.
- b) Modelet e vlerësimit që bazohen në të ardhurat:
 - i. Metoda e raportit çmim/fitim
 - ii. Metoda e normës së fitimeve.
- c) Modelet e vlerësimit që bazohen në rrjedhjen e parasë:
 - i. Modeli i vlerësimit të dividendëve dhe modeli i rritjes së dividendëve
 - ii. Baza e rrjedhjes së skontuar të parasë.

3. Vlerësimi i borxhit dhe pasurive tjera financiare

- a) Aplikimi i metodave të përshtatshme të vlerësimit ndaj:
 - i. borxhit të patërheqshëm
 - ii. borxhit të tërheqshëm
 - iii. borxhit të konvertueshëm
 - iv. aksioneve preferenciale

4. Hipoteza për tregun efikas (EHM) dhe konsideratat praktike në vlerësimin e aksioneve

- a) Dallimi në mes efikasitetit të dobët, efikasitetit gjysmë të fortë dhe efikasiteti të fortë.
- b) Të kuptuarit e konsideratave praktike në vlerësimin e aksioneve dhe biznesit, duke përfshirë:
 - i. tregtueshmërinë dhe likuiditetin e aksioneve
 - ii. disponueshmërinë dhe burimet e informatave
 - iii. papërsosmëritë e tregut dhe anomalitë e vendosjes së çmimit
 - iv. kapitalizimin e tregut.
- c) Të kuptuarit e rëndësisë së spekulimeve të investitorëve dhe vendimet e investitorëve të ofruara nga sjellja në financa.

H Menaxhimi i rrezikut

1. Natyra dhe llojet e rrezikut dhe qasjet në menaxhimin e rrezikut

- a) Të kuptuarit e llojeve të ndryshme të rrezikut të monedhës së huaj:
 - i. rreziku i përkthimit
 - ii. rreziku i transaksionit
 - iii. rreziku ekonomik.
- b) Të kuptuarit e llojeve të ndryshme të rrezikut të normës së interesit:
 - i. ekspozimi ndaj hapësirës
 - ii. rreziku bazë

2. Arsyet për dallimet e kursit të këmbimit dhe luhatjet e normës së interesit

- a) Arsyet për luhatjet e kursit të këmbimit, duke përfshirë:
 - i. bilancin e pagesave

- ii. teorinë e paritetit të fuqisë blerëse
 - iii. teorinë e paritetit të normës së interesit
- b) Parashikimi i kurseve të këmbimit duke përfshirë:
- iv. ekuivalencën katër-anëshe.
 - i. paritetin e fuqisë blerëse
 - ii. paritetin e normës së interesit.
- c) Arsyet për luhatjet e normës së interesit,
1. duke përfshirë:
 - i. strukturën e normave të interesit dhe kurbat e normës
 - ii. teorinë e pritjes
 - iii. teorinë e preferencës së likuiditetit
 - v. segmentimin e tregut

3. Teknikat mbrojtëse nga rreziku i monedhës së huaj

- a) Kuptimi dhe aplikimi i metodave tradicionale dhe themelore për menaxhimin e rrezikut të monedhës së huaj, duke përfshirë:
- i. monedhën e faturës
 - ii. shlyerjen dhe përputhjen
 - iii. parapagesën dhe vonesën e pagesës
 - iv. kontratat e këmbimit të përcaktuara paraprakisht

- v. mbrojtjen në tregun e parasë
- vi. menaxhimin e pasurive dhe detyrimeve.

- b) Krahasimi dhe vlerësimi i metodave tradicionale për menaxhimin e rrezikut të monedhës së huaj.
- c) Identifikimi i llojeve kryesore të derivativeve të monedhës së huaj të përdorura për mbrojtjen nga rreziku i monedhës së huaj dhe përdorimi i tyre në mbrojtjen

4. Teknikat mbrojtëse nga rreziku i normës së interesit

- a) Kuptimi dhe aplikimi i metodave tradicionale dhe themelore për menaxhimin e rrezikut të normës së interesit, duke përfshirë:
- i. përputhjen dhe and zbutjen
 - ii. menaxhimin e pasurive dhe detyrimeve
 - ii. marrëveshjet e së ardhmes për normën e interesit.
 - iii. Identifikimi i llojeve kryesore të derivativave të normave të interesit të përdorura për mbrojtjen nga rreziku i normës së interesit dhe përdorimi i tyre për mbrojtjen